



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2023
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: HISTORI

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	A	A	D	B	D	A	C	D	B
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja e saktë	A	C	B	A	A	A	D	C	D	A

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Pyetja 21 2 pikë

Model përgjigjeje

Ishte demokraci e kufizuar sepse qytetarë me të drejta politike quheshin vetëm 20% e popullsisë: qytetarët e Athinës; qytetarët e lirë dhe banorë të Athinës (nga nëna dhe babai). Të tjerët joqytetarë ishin të huajt, skllavërit dhe gratë të cilët nuk kishin të drejta politike.

Në mbledhjet e Kuvendit të Popullit merrnin pjesë vetëm një pjesë e vogël e qytetarëve më të drejta politike. Gratë nuk kishin të drejtë të votonin.

Skllavëria shikohej si fenomen i natyrshëm

Etj.

2 pikë Nëse jep dy nga argumentet që tregojnë kufizime të demokracisë athinase në kohën e Perikliut.

OSE

1 pikë Nëse jep një nga argumentet që tregojnë kufizime të demokracisë athinase në kohën e Perikliut

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë

Model përgjigjeje

Ndryshimet që solli vendosja e pushtimit romak në Iliri ishin:

- Ndarja e re administrative në 4 provinca: Prevali me qendër Shkodrën, Dardania me qendër Shkupin, Epiri i Ri me qendër Durrësin dhe Epiri i vjetër me qendër Nikopojën;
- Reforma agrare ku një pjesë e tokave ilire ju dhanë qytetarëve, kolonëve dhe veteranëve të luftës romakë;

- Marrja e statusit të kolonive disa qyteteve ilire, rrënimi i disa qyteteve të tjera që humbën rolin e mëparshëm ekonomik-administrativ;
- Ndërtimi i rrugës Egnatia që lidhte Romën me Kostandinopojën;
- Ilirët detyroheshin të paguanin detyrime ndaj romakëve;
- Ndryshime pati në arkitekturë, p.sh. amfiteatri i Dyrrahut;
- Latinishtja u bë gjuha zyrtare duke zëvendësuar mbishkrimet greke.;
- Ndikimin pati edhe e Drejta romake e cila u zbatua në një pjesë të territorit ilir;
- Etj.

2 pikë	Nëse gjen dy nga ndryshimet që solli vendosja e pushtimit romak në Iliri.
1 pikë	Nëse jep një nga ndryshimet që solli vendosja e pushtimit romak në Iliri.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **2 pikë**
Model përgjigjeje

- Mbledhja e taksave bëhej me konsensusin e Këshillit të Përgjithshëm Mbretëror, duke shmangur paligjshmëria dhe dhuna në mbledhjen e tyre;
- Parashikohej ndarja e pushtetit gjyqësor nga ai administrativ dhe shkëputej administrimi i drejtësisë nga vet mbreti;
- Asgjë person nuk mund të arrestohej pa u zhvilluar një proces të rregullt gjyqësor;
- Të pengonte padrejtësitë e funksionarëve të mbretit;
- Të respektohej liria e aristokracisë, kishave dhe komunave;
- Etj.

2 pikë	Nëse jep dy nga parimet e Magna Kartës.
1 pikë	Nëse jep një nga parimet e Magna Kartës.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24
Model përgjigjeje

- a) **1 pikë**
- U quajt Revolucion i Lavdishëm për arsye se kufizimi i pushtetit absolut të mbretit u krye në mënyrë paqësore;
 - Arritja e ndryshimeve revolucionare përparimtare pa dhunë.

1 pikë	Nëse shpjegon termin Revolucion i Lavdishëm.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

- b) **2 pikë**
- U kufizua pushteti i mbretit dhe u fuqizua ai i parlamentit;
- Mbreti nuk kishte të drejtë të anulonte ligjet e miratuara nga parlamenti;
 - Nuk mund të shpërndante parlamentin;
 - Nuk vendoste taksa pa miratimin e parlamentit;
 - Nuk mund të mbante ushtri në kohë paqe;
 - U siguroa mbrojtja e lirisë së qytetarëve;
 - Çdo qytetar gëzonte të drejtën e fjalës, të drejtën ti drejtohej Mbretit me peticion, etj;
 - U hoq censura mbi shtypin;
 - Etj.

2 pikë	Nëse shpjegon dy arritje të Aktit të Lirive dhe të të Drejtave.
1 pikë	Nëse shpjegon një arritje të Aktit të Lirive dhe të të Drejtave.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Pushteti ligjvënës ushtrohej nga Kongresi që është një parlament i ndarë në dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve;
- Pushteti ekzekutiv ushtrohej nga Presidenti, kryetar i shtetit dhe qeverisë , me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje;
- Pushteti gjyqësor ushtrohej nga gjykatat federale, ku kryesorja ishte Gjykata e Lartë.

3 pikë Nëse shpjegon si ushtrohej secili nga pushtetet.**2 pikë** Nëse shpjegon si ushtrohej dy nga pushtetet.**1 pikë** Nëse shpjegon si ushtrohej një nga pushtetet.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 26****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Kuvendi Kombëtar i Vlorës shpalli Pavarësinë e Shqipërisë, pra shkëputjen nga Perandoria Osmane.
- Shpalli neutralitetin me qëllim që të shmangte çdo konflikt që mund të provokonte fqinjët.
- U krijua qeveria e përkohshme e kryesuar nga Ismail Qemali.
- Etj.

3 pikë Nëse jep tre vendimet e Kuvendit të Vlorës.**2 pikë** Nëse jep dy vendimet e Kuvendit të Vlorës.**1 pikë** Nëse jep një vendimet e Kuvendit të Vlorës.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 27****3 pikë****Model përgjigjeje**

Shkaqet ishin:

- Prapambetja ekonomike që kishte rritur pakënaqësinë e popullsisë;
- Pjesëmarrja në Luftën I Botërore që kishte rritur shpenzimet ushtarake;
- Humbjet e mëdha njerëzore nga pjesëmarrja në Luftë;
- Autoritarizmi i carëve rus;
- Pushteti i madh i pronarëve të tokës mbi fshatarësinë;
- Diskriminimi i pakicave kombëtare;
- Veprimtaria gjithnjë në rritje e Partisë Komuniste(Bolshevike) nën drejtimin e Leninit.
- Etj.

3 pikë Nëse shpjegon tri nga shkaqet që çuan në revolucionin e vitit 1917 në Rusi.**2 pikë** Nëse gjen dy nga shkaqet që çuan në revolucionin e vitit 1917 në Rusi.**1 pikë** Nëse gjen një nga shkaqet që çuan në revolucionin e vitit 1917 në Rus.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28**3 pikë****Model përgjigjeje**

Vendimet e Konferencës së Versajës (1919) nuk mundën të siguronin arritjen e një paqe afatgjatë dhe sipas historianëve kjo çoi në shpërthimin e Luftës së II-të Botërore.

Argumentet:

- Kriza e sisteme politike të pas luftës, që u shoqërua më një paqëndrueshmëri të madhe politike;
- Kushtet e vështira që Gjermania u detyrua të nënshkruaj, ishte një “paqe e diktuar”, që i hapi rrugë lulëzimit të ekstremit të majtë me ardhjen e Hitlerit në pushtet;
- Kriza e madhe ekonomike e viteve 1929 – 1932 e rrënoi pushtetin politik duke i hapur rrugën ekstremistëve për të marr pushteti.
- Lidhja e Kombeve u tregua shumë e dobët duke dështuar në misionin e saj që ishte ruajtja e paqes.
- Krijimi i shteteve të reja, të cilat u treguan të dobëta politikisht dhe ekonomikisht përballë fqinjëve të tyre të fuqishëm si Gjermania dhe Rusia (BS).
- Etj.

3 pikë Nëse shpjegon tri nga argumentet pse vendimet e Konferencës së Paqes nuk arritën të siguronin një paqe afatgjatë;

2 pikë Nëse gjen dy nga argumentet pse vendimet e Konferencës së Paqes nuk arritën të siguronin një paqe afatgjatë;

1 pikë Nëse gjen një nga argumentet pse vendimet e Konferencës së Paqes nuk arritën të siguronin një paqe afatgjatë;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Shpërndarja e të gjitha partive dhe sindikatave jofashiste.
- Ndalimi i lirisë së fjalës, shtypit dhe veprimit.
- Ndalimi i protestave dhe lëvizjeve greviste.
- Krijimi i një aparati të gjerë burokratik partiak dhe shtetëror.
- U vendos censura.
- U krijua “grykë speciale” që gjykonte krimet ndaj shtetit.
- Ngritja e institucioneve fashiste.
- Ngritja e policisë sekrete OVRA që kontrollonte dhe dënonte çdo kundërshtar.
- Ngritja e një rrjeti të gjerë spiunazhi.
- Etj.

3 pikë Nëse gjen tri nga masat që mori qeveria fashiste e Musolinit për të konsoliduar pushtetin.

2 pikë Nëse gjen dy nga masat që mori qeveria fashiste e Musolinit për të konsoliduar pushtetin.

1 pikë Nëse gjen një nga masat që mori qeveria fashiste e Musolinit për të konsoliduar pushtetin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30**Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

Doktrina Truman konsideronte çdo ndërhyrje të BS në vendet e tjera, si një sulm ndaj interesave amerikane

- 1 pikë** Nëse gjen përmbytjen e doktrinës.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) 2 pikë

- Dy objektivat e Planit Marshall ishin të ndihmonte në rimëkëmbjen ekonomike të vendeve evropiane të shkatërruara nga lufta duke kufizuar ndikimin sovjetik.
- Të krijonte tregje të reja për mallrat amerikan.
- Etj.

- 2 pikë** Nëse gjen dy objektivat e Planit Marshall.
1 pikë Nëse gjen një objektivat e Planit Marshall.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Pronësia shtetërore mbi mjetet e prodhimit u shndërrua në pronësi shoqërore.
- Përgjegjësitë e administrimit iu kalua punëtorëve të çdo ndërmarrjeje nëpërmjet "këshillave të punëtorëve, të cilat kishit ë drejtë të përcaktonin planifikimin, tregtimin, vendosjen e çmimeve, të pagës së punëtorëve.
- Në sektorin e bujqësisë nisi shkrirja e kooperativave dhe fermave shtetërore, që çoi në nxitjen e fshatarëve për të prodhuar dhe investuar.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse gjen tri nga karakteristikat e vetadministrimit jugosllav.
2 pikë Nëse gjen dy nga karakteristikat e vetadministrimit jugosllav.
1 pikë Nëse gjen një nga karakteristikat e vetadministrimit jugosllav.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Shpalli të shkarkuar qeverinë e Durrësit.
- Krijoi qeverinë e re.
- Shkarkoi delegacionin zyrtar në Konferencën e Paqes.
- Formoi delegacionin e ri që do merrte pjesë në Konferencën e Paqes.
- Hodhi poshtë projektet e Konferencës së Paqes për Shqipërinë.
- Kundërshtoi çdo lloj protektorati të huaj, duke kërkuar pavarësinë e plotë dhe paprekshmërinë e tërësisë territoriale të Shqipërisë.
- Miratoi Statutin Organik të Lushnjës.
- Zgjodhi Këshillin Kombëtar.
- Krijoi Këshillin e Lartë.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse gjen tri nga vendimet e Kongresit të Lushnjës.
2 pikë Nëse gjen dy nga vendimet e Kongresit të Lushnjës.
1 pikë Nëse gjen një nga vendimet e Kongresit të Lushnjës.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33**Model përgjigjeje**a) **1 pikë**

Sipas Paktit të parë të Tiranës, Italia fitonte të drejtën të ndërhynte në Shqipëri në rast se cenohej Statukuoja politike, juridike dhe tokësore e Shqipërisë

1 pikë Nëse përcakton përmbajtjen e Paktit të parë të Tiranës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) **1 pikë**

Pakti i dytë i Tiranës përcaktonte ndërhyrjen e Italisë në Shqipëri, në rast lufte dhe agresioni të jashtëm.

1 pikë Nëse përcakton përmbajtjen e Paktit të dytë të Tiranës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 34**Model përgjigjeje**a) **1 pikë**

Qëllimi i mbledhjes së Kongresit të Përmetit ishte se disfata e Gjermanisë ishte afër dhe duhej të zgjidhej çështja e pushtetit, ku PKSH dhe Fronti Antifashist kërkonin të krijonin një qeveri.

1 pikë Nëse gjen qëllimin e mbledhjes së Kongresit të Përmetit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

b) **2 pikë**

Vendimet e Kongresit të Përmetit ishin:

- Krijimi i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ), si organi më i lartë legjislativ dhe ekzekutiv me në krye Omer Nishani;
- U krijua Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar, me atributet e një qeverie të përkohshme;
- U zgjodh Enver Hoxha komisar politik dhe komandant i përgjithshëm i Ushtrisë;
- U vendosën gradat në ushtri
- U ndalua kthimi në Shqipëri i mbretit Zog
- Forma e regjimit do të vendosej me votë popullore pas luftës
- Të mos njihet asnjë qeveri tjetër si brenda dhe jashtë vendit;
- Do të rishikoheshin të gjitha marrëveshjet e lidhura më parë.
- Etj.

2 pikë Nëse jep dy nga vendimet e Kongresit të Përmetit.

1 pikë Nëse jep një nga vendimet e Kongresit të Përmetit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 35**Model përgjigjeje**a) **1 pikë**

Ngjarje politike ndërkombëtare që çoi në vendosjen e marrëdhënieve të ngushta mes Shqipërisë dhe Kinës ishte për shkak të prishje së marrëdhënieve me BS të Shqipërisë dhe mbetjes pa një aleat të madh dhe pa ndihma ekonomike dhe ushtarake.

1 pikë Nëse gjen arsyen e vendosjes së marrëdhënieve shqiptaro - kineze;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

b) **1 pikë**

c) Arsyet që çoi në prishjen e marrëdhënieve:

- Hapja e Kinës kundrejt SHBA.
- Ndryshimi i qëndrimit të Kinës pas kësaj hapje.
- Etj.

1 pikë Nëse gjen një nga arsyet prishjes së marrëdhënieve shqiptaro - kineze;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.